



Politizimi kundër kushtetues i ANJF



*Nga Agjenci e Pavarur në
Ministri të Drejtësisë*

Autor: Gzim Shala

Ekipi redaktues: Ehat Miftaraj dhe Betim Musliu

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë për Çështje të Narkotikëve Ndërkombëtarë dhe Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan.

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Ilaz Agushi
Prishtinë
E: info@kli-ks.org
www.kli-ks.org

Përkrahur nga:

Tetor, 2022
Prishtinë, Republika e Kosovës



Përmbajtja

1. Përmbledhje ekzekutive.....	4
2. Ndihma juridike falas	5
3. Inkorporimi i ANJF në MD	5
4. Politizimi i ndihmës juridike	6
5. Fuzionimi i të paditurit dhe paditësit	6
6. Cenimi i të drejtave të njeriut dhe kundër kushtetutshmëria e inkorporimit të ANJF në MD 8	
7. Nevoja për reagim të Avokatit të Popullit	9

1. Përmbledhje ekzekutive

Me qëllim të, siç thuhet në Ligj, racionalizimit dhe vendosjes së vijave llogaridhënese të Agjencive të Pavarura, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Ligjin Nr.08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënese të Agjencive të Pavarura (Tutje: Ligji Nr.08/L-063), i cili ka hyrë në fuqi më 21 shtator 2022. Përmes këtij ligji, është shuar Këshilli për Ndhimë Juridike Falas, si organ mbikëqyrës i Agjencisë për Ndhimë Juridike Falas (Tutje: ANJF). Me këtë ligj, ANJF është inkorporuar në Ministrinë e Drejtësisë.

Ligji Nr.08/L-063 duke e synuar racionalizimin e institucioneve dhe duke e sistemuar ANJF në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, e ka politizuar sistemin e ndihmës juridike falas në Kosovë. Duke nisur nga politikat e përgjithshme e deri tek vendimet e veçanta, do të vendosë Ministria e Drejtësisë, si institucion që udhëhiqet nga një i emëruar politik. Përfundimisht, tani mund të thuhet se mbi kërkesat e qytetarëve për ofrimin e ndihmës juridike falas do të vendos një institucion politik. Për më tepër, sipas ligjit të ri, edhe kriteret për ofrimin e ndihmës juridike nga OJQ do të përcaktohen nga Ministria e Drejtësisë.

Krahas politizimit të ANJF, tanimë në Ministrinë e Drejtësisë praktikisht janë fuzionuar edhe ndërgjyqjësit, përkatësisht i padituri dhe paditësi. Kështu, paradoksalisht, për rastet e njëjta, Ministria e Drejtësisë do të duhet të kujdeset edhe për mbrojtjen e interesit të qytetarëve edhe për mbrojtjen e interesit të institucioneve publike. Pra, edhe për interesin e paditësit edhe interesin e të paditurit.

Në linjë me standardet e përcaktuara nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Tutje: GjEDNj) IKD gjen se Ligji Nr.08/L-063 nuk ka përcaktuar një ekuilibër ndërmjet qasjes në drejtësi dhe pavarësisë së profesionistëve ligjor që ofrojnë ndihmë juridike falas. Politizimi i ANJF, inkorporimi i saj në Ministrinë e Drejtësisë dhe krijimi i situatës ku ANJF përmes ofrimit të ndihmës juridike do të mbrojë të drejtat e qytetarëve përballë institucioneve që përfaqësohen nga Avokatura Shtetërore, të dy këto institucione nën ombrellën e Ministrisë së Drejtësisë, privon përfituesit e ndihmës juridike falas për qasje efektive në drejtësi.

Kështu, nën këtë rregullim të ri ligjor, qytetarët tanimë nuk kanë siguri të mjaftueshme juridike që për rastet e tyre që kanë nevojë për ndihmë juridike falas të kërkojnë ndihmë juridike nga ANJF. Kështu, ky rregullim ligjor, ka cenuar të drejtën e qytetarëve për ndihmë juridike falas, sipas standardeve të përcaktuara nga GjEDNj, standarde këto obligative në rendin kushtetues kosovar. Për këtë arsye, ky projektligj është në kundërshtim me nenin 31.6 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Me qëllim të mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe të drejtave dhe lirive themelore të qytetarëve, reagimi i Avokatit të Popullit në këtë situatë është i domosdoshëm. Me këtë rast, pas kësaj analize, Avokati i Popullit sipas kompetencës së tij të përcaktuar me Kushtetutë duhet ta procedojë Ligjin Nr.08/L-063 në Gjykatën Kushtetuese për vlerësim të kushtetutshmërisë.

2. Ndhimja juridike falas

Ofrimi i ndihmës juridike falas hyn në kuadër të të drejtave të njeriut. Në Kushtetutën e Kosovës, ndihma juridike falas hynë në kuadër të të drejtave të akuzuarit¹ dhe të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm². Si pjesë e të drejtës për një proces të rregullt gjyqësor, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut ndihmën juridike e ka garantuar për rastet penale³ derisa duke u nisur nga fakti se Konventa synon të mbrojë, veçanërisht, qasjen në drejtësi, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka përcaktuar se neni 6.1. i Konventës, nën rrethana të caktuara, mund ta obligojë shtetin të siguroj ndihmë juridike falas edhe në rastet e tjera të cilat nuk bien në domenin penal⁴.

Ligji bazik i cili rregullon mënyrën e ofrimit të ndihmës juridike falas në Kosovë është Ligji Nr. 04/L-017 për Ndhimë Juridike Falas, i ndryshuar me ligjet Nr.08/L-035 dhe Ligjin Nr.08/L-063. Mbrojtja juridike falas u ofrohet të gjitha subjekteve të cilat plotësojnë kriteret e përcaktuara me ligj. Sipas këtij ligji, mbrojtja juridike, ndër të tjera, nënkupton përfaqësimin në procedurën civile, penale, administrative dhe kundërvajtëse⁵. Sipas këtij ligji, përgjegjëse për organizimin dhe ofrimin e ndihmës juridike falas është Agjencia për Ndhimë Juridike Falas. Kjo Agjenci, gjatë vitit 2021, ka ofruar ndihmë juridike falas në 2560 raste administrative, 1734 rasteve civile, 211 raste penale dhe 94 rasteve kundërvajtëse.

3. Inkorporimi i ANJF në MD

Sipas Ligjit Nr. 04/L-017 për Ndhimë Juridike Falas [neni 19.2.] ANJF është institucion i pavarur publik i cili ushtron funksionet dhe përgjegjësitë në pajtim me këtë ligj. Sipas këtij ligji [neni 11] mbikëqyrëse e punës së Agjencisë ka qenë Këshilli për Ndhimë Juridike Falas, si institucion i pavarur.

Më 21 shtator 2022 ka hyrë në fuqi Ligji Nr.08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të Agjencive të Pavarura. Ky ligj ka shuar Këshillin për Ndhimë Juridike Falas, me ç'rast kompetencat e këshillit i kanë kaluar Ministrisë së Drejtësisë.

Kështu, sipas Ligjit Nr.08/L-063 [neni 19.3) ANJF është pjesë përbërëse e Ministrisë së Drejtësisë. Me këtë ligj [neni 12], është shfuqizuar dispozita që i garanton ANJF menaxhim të pavarur të buxhetit dhe rekrutim të pavarur të personelit. Kështu, ANJF tanimë është pjesë e Ministrisë së Drejtësisë dhe për veprimet e veta i raporton kësaj Ministrie.

¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 30.5.

² Po aty, neni 31.6.

³ Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 6.3.c.

⁴ AIREY k. Irlandës, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, 9 tetor 1979, par.26; McVICAR kundër Mbretërisë së Bashkuar, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, 7 gusht 2002, par.48.

⁵ Ligji Nr. 04/L-017 për Ndhimë Juridike Falas, kreu II.

4. Politizimi i ndihmës juridike

Ministria e Drejtësisë udhëhiqet nga Ministri i Drejtësisë, i cili është person i emëruar politik. Në këtë mënyrë, ANJF nga një Agjenci e cila i ka raportuar një trupe të pavarur të themeluar enkas për ta mbajtur llogaridhënës ANJF tanimë ka hyrë nën ombrellën e një institucioni politik.

Sipas Ligjit Nr.08/L-063 [neni 13] Ministria është përgjegjëse për hartimin e politikave dhe rregullave për ofrimin e ndihmës juridike falas, ushtrimin e mbikëqyrjes së punës dhe funksionimit gjithëpërfshirës të sistemit të ndihmës juridike falas dhe identifikimin e prioriteteve në ofrimin e ndihmës juridike falas në varësi të burimeve dhe mjeteve financiare në dispozicion. Sipas ligjit të ri [neni 34] organ epror i cili i shqyrton ankesat ndaj vendimeve të ANJF është komisioni për ankesa. Ky komision, sipas ligjit të ri, themelohet nga ministri me akt nënligjor. Për më tepër, Ligji Nr.08/L-063 i ka dhënë Ministrisë së Drejtësisë kompetencë që të përcaktojë kriteret për ofrimin e ndihmës juridike falas nga OJQ-të.

Pra, Ligji Nr.08/L-063 duke e synuar racionalizimin e institucioneve dhe duke e sistemuar ANJF në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, e ka politizuar sistemin e ndihmës juridike falas në Kosovë. Duke nisur nga politikat e përgjithshme e deri tek vendimet e veçanta, do të vendosë Ministria e Drejtësisë, si institucion që udhëhiqet nga një i emëruar politik. Përfundimisht, tani mund të thuhet se mbi kërkesat e qytetarëve për ofrimin e ndihmës juridike falas do të vendos një institucion politik.

5. Fuzionimi i të paditurit dhe paditësit

Në procedurat administrative, gjyqësore apo të arbitrazhit, institucionet publike parimisht përfaqësohen nga Avokatura Shtetërore. Sipas Ligjit Nr.04/L-157 për Avokaturën Shtetërore, *“Avokatura Shtetërore përfaqëson, jep këshilla dhe mbron autoritetet publike të Republikës së Kosovës, të përcaktuara me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, në procedurën gjyqësore, të arbitrazhit dhe në procedurën administrative në pajtim me ligjin”*⁶.

Avokatura Shtetërore është organ qendror i administratës në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë. Avokatura Shtetërore udhëhiqet nga Avokati i Përgjithshëm Shtetëror i cili i përgjigjet Ministrisë së Drejtësisë⁷.

Kështu, Avokatura Shtetërore mbron institucionet publike edhe kur ato paditen nga ana e qytetarëve. Qytetarë që padisin institucionet publike janë, ndër të tjerë, edhe qytetarët të cilët i plotësojnë kushtet për të qenë përfitues të ndihmës juridike falas në ANJF. Kështu, qytetarët kërkojnë ndihmë juridike nga ANJF për të paditur institucionet publike, qoftë në procedura gjyqësore civile apo procedura gjyqësore administrative. Praktikisht, kjo ka ndodhur deri më tani në dhjetëra mijëra raste. Sipas statistikave të ANJF, gjatë vitit 2021, kjo Agjenci ka ofruar ndihmë juridike falas në 1,961 raste të cilat kanë qenë të drejtuara kundër vendimeve të institucioneve publike, në vitin 2020 në 2,826 raste, derisa në vitin 2019 ka ofruar ndihmë

⁶ Ligji Nr. 04/L-157 për Avokaturën Shtetërore, neni 8.

⁷ Po aty, neni 7 dhe 9.

juridike falas në 2,539 raste të kësaj natyre. Që nga viti 2008 deri me sot, nga gjithsej 59,787 shërbime të ofruara, 35,411 prej tyre kanë të bëjnë me raste të natyrës administrative, kryesisht kundër vendimeve të nxjerra nga organet publike, përfshirë organet qeveritare. Përkatesisht, rreth 60% të totalit të shërbimeve të ndihmë juridike të ofruara nga të ofruara nga Agjencia kanë të bëjnë me vendimet e nxjerra nga organet publike. Pra, në këto raste, ANJF ka mbrojtur të drejtat e qytetarëve të cilët kanë pretenduar se u janë shkelur të drejtat nga institucionet publike.

Nisur nga fakti se institucionet publike përfaqësohen nga Avokatura Shtetërore, i bie se ANJF ka ofruar ndihmë juridike për palën paditëse ndërsa Avokatura Shtetërore ka qenë palë e paditur, apo anasjelltas.

Pas inkorporimit të ANJF në Ministrinë e Drejtësisë, si ANJF ashtu edhe Avokatura Shtetërore obligohen që ti raportojnë eprorit të njëjtë: Ministrit të Drejtësisë. Kështu, përkundër që ANJF dhe Avokatura Shtetërore janë palë⁸ ndërgjyqëse nëpër shumë procese gjyqësore, ku ANJF mbron interesin e qytetarëve ndërsa Avokatura Shtetërore mbron interesin e institucioneve publike, të dy këto institucione në fund do t'i raportojnë Ministrit, i cili është i përzgjedhur politik. Në një ankesë potenciale ndaj (mos) veprimeve të ANJF në një rast të caktuar kundër institucioneve publike, që përfaqësohen nga Avokatura Shtetërore, paradoksisht ankesat do të trajtohen nga Ministria e Drejtësisë, në kuadër të së cilës është edhe Avokatura Shtetërore.

Në këtë mënyrë, krahas inkorporimit të ANJF në Ministrinë e Drejtësisë, tanimë në këtë ministri janë fuzionuar edhe ndërgjyqësit, përkatesisht i padituri dhe paditësi. Kështu, paradoksisht, për rastet e njëjta, Ministria e Drejtësisë do të duhet të kujdeset edhe për mbrojtjen e interesit të qytetarëve edhe për mbrojtjen e interesit të institucioneve publike. Pra, edhe për interesin e paditësit edhe interesin e të paditurit. Kështu, në secilin rast, Ministria e Drejtësisë në të njëjtën kohë do ta ketë edhe një sukses edhe një dështim.

Kjo situatë cenon rëndë pavarësinë dhe besueshmërinë e Avokaturës Shtetërore dhe, veçanërisht, ANJF. Potenciali për dirigjimin e politikave të caktuara nga Ministri i Drejtësisë si i përzgjedhur politik për të dobësuar njërin palë në raport me palën tjetër është shumë i lartë. Nën këto rrethana, siguria e qytetarëve, të paktën në perceptimin e tyre, për të kërkuar ndihmë juridike nga një Agjenci e cila i raporton Ministrit të Drejtësisë, për një rast kundër Avokaturës Shtetërore e cila i raporton personit të njëjtë, cenohet seriozisht.

Kështu, pas inkorporimit të ANJF në Ministrinë e Drejtësisë, kësaj Agjencie tanimë i mungon pavarësia objektive në punën e saj.

⁸ *Shënim:* ANJF sipas Ligjit Nr. 04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas [neni 5] ofron ndihmë juridike primare dhe sekondare, për qytetarët të cilët i plotësojnë kushtet për të përfituar ndihmë juridike falas. Parashtrësat e ndryshme [paditë, ankesat etj.] përpilohen nga zyrtarët e ANJF derisa përfaqësimi bëhet nga Avokatët të cilët angazhohen dhe kompensohen nga ANJF. Kështu, ligjërisht, ANJF nuk është palë në procedurë, por se nisur nga fakti se kryen këto shërbime për qytetarët të cilët i plotësojnë kushtet për të përfituar ndihmë juridike falas, praktikisht i bie se edhe ANJF mund të konsiderohet një lloj paditësi/i padituri, pasi të gjitha shërbimet i kryen për dhe në llogari të paditësit/të paditurit.

6. Cenimi i të drejtave të njeriut dhe kundër kushtetutshmëria e inkorporimit të ANJF në MD

Siç u tha më lartë, mbrojtja juridike falas është e garantuar me Kushtetutë. Kjo e drejtë konsiderohet si e drejtë e njeriut, në kuadër të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Po ashtu, kjo e drejtë garantohet edhe përmes nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Konventë kjo e aplikueshme drejt për së drejti në sistemin juridik kosovar [neni 22 (2) i Kushtetutës]. Sipas Kushtetutës [neni 53] “[t]ë drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.

Sa i përket mbrojtjes juridike, GjEDNJ ka nënvizuar se shteti nuk është përgjegjës për veprimet e një avokati të caktuar zyrtarisht. Këtë mohim të përgjegjësisë së shtetit, GjEDNJ e ndërlidh me pavarësinë që ka profesioni ligjor apo profesionistët ligjor nga shteti, përkatësisht nga institucionet publike⁹. Pra, arsyeja se pse shteti nuk konsiderohet përgjegjës për veprimet dhe mos veprimet e avokatëve ka të bëjë me faktin se profesionet ligjore janë të pavarura nga institucionet e tjera. Pra, për tu hequr kjo përgjegjësi nga shteti, kërkohet pavarësim i profesionit ligjor nga shteti.

Sipas praktikës së GjEDNJ, është përgjegjësi e shtetit që të sigurojë ekuilibrin e nevojshëm ndërmjet gëzimit efektiv të së drejtës për qasje në drejtësi në njërin anë dhe pavarësisë së profesionit të avokatit në anën tjetër. Sipas gjykatës, këto kërkesa nuk përmbushen atëherë kur mangësitë në sistemin e ndihmës juridike privojnë individët nga qasja praktike dhe efektive në gjykatë¹⁰.

Pavarësia dhe paanshmëria e odave të avokatëve është edhe një prej elementeve të pavarësisë dhe paanshmërisë, komponentë kjo bazike e parimit të qasjes në drejtësi. Sipas Komisionit të Venecias, oda e avokatëve luan një rol themelor në sistemin gjyqësor. Për këtë arsye, është e rëndësishme që organizimi i odave të sigurojë pavarësinë dhe funksionimin e duhur. Për të garantuar këtë pavarësi, janë të nevojshme procedimet penale dhe disiplinore. Sipas këtij Komisioni, etika profesionale nënkupton, ndër të tjera se një avokat duhet ta ruajë pavarësinë dhe ti ofrohet mbrojtje për tu dhënë klientëve këshilla dhe përfaqësim të paanshëm¹¹.

Në praktikën e GjEDNJ apo në standardet e përcaktuara nga Komisioni i Venecias, kur flitet për nevojën për pavarësi të avokatëve, argumenti nuk është i ndërlidhur vetëm në titullin që mbanë një profesionist ligjor. Argumenti në këtë rast është i drejtuar në drejtim të shërbimeve që i njëjti kryen: ofrimi i ndihmës juridike. Për këtë arsye, përderisa shërbimet e ndihmës juridike që ofron ANJF janë të njëjta me ato të avokatëve, standardet e njëjta përshtatshëm vlejné edhe për ANJF.

⁹ Staroszczyk k. Polonisë, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, 22 mars 2007, par.133.

¹⁰ Guide on Article 6 of the European Convention on Human Rights, European Court of Human Rights, updated to 31 august 2022, par.167.

¹¹ Rule of Law Checklist, European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), 2016, f.97–98.

Këto standarde të përcaktuara nga GjEDNj dhe Komisioni i Venecias, nuk i kalon Ligji Nr.08/L-063. Siç u tha edhe më lartë, përgjegjësia e shtetit për përfaqësim të klientëve nga profesionistët ligjor nuk bie në rastet kur profesionistët ligjor nuk kanë pasur pavarësi të mjaftueshme. Kështu, marrja e pavarësisë funksionale të ANJF dhe politizimi i saj, nuk është në përputhje me këto standarde. Kështu, për secilin dështim të ANJF në raport me përfituesit e ndihmës juridike falas, Ministria e Drejtësisë nuk përjashtohet nga përgjegjësia.

Tutje, Ligji Nr.08/L-063 nuk ka përcaktuar një ekuilibër ndërmjet qasjes në drejtësi dhe pavarësisë së profesionistëve ligjor që ofrojnë ndihmë juridike falas. Inkorporimi i ANJF në Ministrinë e Drejtësisë dhe krijimi i një situatë ku ANJF do të mbrojnë të drejtat e qytetarëve përballë institucioneve që përfaqësohen nga Avokatura Shtetërore, të dy këto institucione nën ombrellën e Ministrisë së Drejtësisë, privon përfituesit e ndihmës juridike falas për qasje efektive në drejtësi.

Siç u tha, profesionistët ligjor luajnë një rol të rëndësishëm për sistemin gjyqësor. Situatat kur gjykata do të vendosë në mes të dy palëve ndërgjyqëse, të cilat janë pjesë e institucionit të njëjtë, domosdoshmërisht se do të ndikojë negativisht edhe në drejtshmërinë e proceseve gjyqësore.

Në anën tjetër, kompetencat e Ministrit të Drejtësisë për të vendosur si për organin që përfaqëson përfituesit e ndihmës juridike ashtu edhe për organin që përfaqëson institucionet publike, krijon potencial të madh për kurdisje të politikave dhe vendimeve të tjera. Edhe perceptimi se kjo mund të ndodhë është shumë i dëmshëm.

Për këto arsye, nën këtë rregullim të ri ligjor, qytetarët tanimë nuk kanë siguri të mjaftueshme juridike që për rastet e tyre që kanë nevojë për ndihmë juridike falas të kërkojnë ndihmë juridike nga ANJF. Kështu, ky rregullim ligjor, ka cenuar të drejtën e qytetarëve për ndihmë juridike falas, sipas standardeve të përcaktuara nga GjEDNj, standarde këto obligative në rendin kushtetues kosovar. Për këtë arsye, ky projektligj është në kundërshtim me nenin 31.6 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

7. Nevoja për reagim të Avokatit të Popullit

Sipas Kushtetutës [Neni 132.1] “*Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike*”. Me qëllim të ushtrimit praktik të këtij roli, Kushtetuta i ka dhënë kompetenca të caktuara Avokatit të Popullit, ndër të cilat është edhe e drejta për të iniciuar ligje në Gjykatën Kushtetuese, kur gjen se ligje të caktuara nuk janë në përputhje me Kushtetutën¹².

Siç u argumentua në këtë analizë, Ligji Nr.08/L-063 cenon të drejtat e njeriut të garantuara me Kushtetutë. Përkatësisht, Ligji Nr.08/L-063 ndërhyjnë në të drejtën për gjykim të drejtë dhe të

¹² Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 113.2 (1).

paanshëm, e drejtë kjo që nuk mund të cenohet as gjatë periudhës së gjendjes së jashtëzakonshme¹³.

Për këtë arsye, me qëllim të mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe të drejtave dhe lirive themelore të qytetarëve, reagimi i Avokatit të Popullit në këtë situatë është i domosdoshëm. Me këtë rast, pas kësaj analize, Avokati i Popullit sipas kompetencës së tij të përcaktuar me Kushtetutë duhet ta procedojë Ligjin Nr.08/L-063 për vlerësim në Gjykatën Kushtetuese.

¹³ Po aty, neni 56.2.